

Statistikat e Kulturës

Tremujori III 2017

Tiranë, më 24 Nëntor 2017: Në tremujorin e tretë 2017, janë realizuar 66 shfaqje kulturore, duke shënuar rritje me 1,5 %, kundrejt tremujorit të tretë 2016. Numri i spektatorëve në tremujorin e tretë 2017 është rreth 17 mijë, duke pësuar rritje me 34,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve/ekspozitave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/ekspozitave	Tr.2-2016	Tr.2-2017	Tr.3-2016	Tr.3 2017
Teatri Kombëtar Popullor	29	43	9	8
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	41	21	8	5
Teatri Kombëtar Eksperimental	95	76	9	10
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	39	15	20	22
Galeria Kombëtare e Arteve	7	5	4	3
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	64	57	15	18
Shfaqje kulturore gjithsej	275	217	65	66

Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e tretë 2017 është 268 spektatorë/vizitorë për shfaqje, dhe ka pësuar rritje me 32,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2016.

Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve/vizitorëve në institucionet kulturore

Numri i spektatorëve /vizitorëve/audiencia	Tr.2-2016	Tr.2-2017	Tr.3-2016	Tr.3 2017
Teatri Kombëtar Popullor	6.522	12575	3.383	3.617
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	6.320	16.693	790	4.583
Teatri Kombëtar Eksperimental	12.738	10.974	1.263	1.559
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	1.980	660	300	550
Galeria Kombëtare e Arteve	5.520	5.841	4.410	4.633
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	7.312	7.396	3.000	2.757
Numri i spektatorëve gjithsej	40.392	54.139	13.146	17.699

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, në tremujorin e tretë 2017, është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve kulturore, me 22 shfaqje/ekspozita. Në tremujorin e tretë 2017, numri i spektatorëve është 550, duke shënuar rritje 83,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2016. Numri mesatar i spektatorëve në tremujorin e tretë 2017 është 25 spektatorë/vizitorë për shfaqje me një rritje prej 66,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Numri i shfaqjeve kulturore të realizuara nga Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë në tremujorin e tretë 2017 është 18 shfaqje/ekspozita, duke shënuar rritje me 20,0 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2016. Në tremujorin e tretë 2017, numri i spektatorëve është 2.757, duke shënuar rënie me 8,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë 2016. Numri mesatar i spektatorëve në tremujorin e tretë 2017 është 153 spektatorë/vizitorë për shfaqje duke pësuar rënie me 23,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Tab. 3 Vizitorë në Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala

Numri i vizitorëve	Tr.2-2016	Tr.2-2017	Tr.3-2016	Tr.3 2017
Muze	41.369	56.375	64.975	78.479
Kala e Monumente të tjera	46.720	58.059	86.554	102.621
Parqe Arkeologjike	65.412	71.773	138.122	150.859
Numri i vizitorëve gjithsej	153.501	186.207	289.651	331.959

Numri i vizitorëve në muze në tremujorin e tretë 2017 është 78.479, duke shënuar rritje me 20,8 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2016. Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 18,6 %, midis tremujorit të tretë 2017 dhe të njëjtit tremujor në vitin 2016. Në tremujorin e tretë 2017 numri i vizitorëve në parqe arkeologjike është 150.859, me një rritje prej 9,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Tab. 4 Frekuentimi dhe botimet në Bibilotekën Kombëtare

Treguesit	Tr.2-2016	Tr.2-2017	Tr.3-2016	Tr.3 2017
Shërbimi i njësive bibliotekare (njësi)	45.360	22.524	45.556	24.798
Frekuentimi	50.023	26.294	46.349	29.552
Numri i botimeve	3.289	3.322	2.848	2.851
Numri i titujve të rinj gjatë vitit	711	661	607	609
Numri i ekzemplarëve të rinj gjatë vitit	2.578	2.661	2.241	2.242

Numri i shërbimeve të njësive bibliotekare dhe numri i frekuentuesve të Bibilotekës Kombëtare në tremujorin e tretë 2017 është përgjysmuar krahasuar me tremujorin e tretë 2016. Në tremujorin e tretë 2017, në Bibilotekën Kombëtare janë afishuar 2.851 botime, 0,1 % më shumë, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga këto botime 609 ishin tituj të rinj dhe 2.242 ekzemplarë të rinj.

Shënime Metodologjike

Në institucionet qendrore të artit përfshihen:

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor (TKOBAP), Teatri Kombëtar (TK), Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (TKEKS), Galeria Kombëtare e Arteve (GKA), Cirku Kombëtar (CK), Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF), Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave (QKKFTK), Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala.

Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës.